



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYEMINISTRI

U R D H Ë R

Nr. 145 , datë 20.12.2021

PËR

**NGRITJEN DHE FUNKSIONIMIN E KOMITETIT SHUMËPALËSH
MBI PARTNERITETIN PËR QEVERISJE TË HAPUR**

Në mbështetje të pikës 3, të nenit 102, të Kushtetutës, dhe të nenit 11, të ligjit nr.9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”,

U R D H Ë R O J:

1. Ngritjen e Komitetit Shumëpalësh mbi Partneritetin për Qeverisje të Hapur, në vijim referuar si Komiteti Shumëpalësh, në përputhje me standardet e Iniciativës Globale për Qeverisje të Hapur (referuar në vijim si Iniciativa OGP).
2. Ministritë e linjës dhe institucionet qendrore të marrin masa për zbatimin e Planit Kombëtar për Qeverisje të Hapur, që miratohet nga Komiteti Shumëpalësh çdo dy vjet, në përputhje me standardet e Iniciativës Globale për Qeverisje të Hapur.
3. Komiteti Shumëpalësh të bashkëkryesohet nga Zëvendëskryeministri, i cili është (në nivel politik), Koordinatori Kombëtar për Iniciativën OGP dhe nga përfaqësuesi i anëtarëve të organizatave jofitimprurëse në Komitetin Shumëpalësh, i cili përcaktohet nga vetë anëtarët e organizatave në Komitet, dhe në përbërje të tij të ketë këta anëtarë:
 - Ministrin përgjegjës për Evropën dhe punët e jashtme;
 - Ministrin përgjegjës për punët e brendshme;
 - Ministrin përgjegjës për financat dhe ekonominë;
 - Ministrin përgjegjës për drejtësinë;
 - Ministrin përgjegjës për standardet dhe shërbimet;
 - Ministrin përgjegjës për sipërmarrjen;
 - Drejtorin e strukturës teknike për mirëqeverisjen dhe/ose përgjegjës për koordinimin e punës me institucionet dhe Iniciativën OGP, që vepron si sekretariat teknik, në Kryeministri;

- Drejtorin e Përgjithshëm të Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit;
- Drejtorin Ekzekutiv të Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile;
- Drejtorin e Përgjithshëm të Agjencisë për Dialog dhe Bashkëqeverisje;
- Përfaqësues të shoqatës më të përfaqësuar të vetëqeverisjes vendore;
- Anëtarin e Këshillit Kombëtar të Shoqërisë Civile, përfaqësuesin e shoqërisë civile nga fusha e demokratizimit, shtetit të së drejtës, të të drejtave të njeriut dhe integrimi në Bashkimin Evropian;
- Anëtarin e Këshillit Kombëtar të Shoqërisë Civile, përfaqësuesin e shoqërisë civile nga fusha e zhvillimit ekonomik;
- Anëtarin e Këshillit Kombëtar të Shoqërisë Civile, përfaqësuesin e shoqërisë civile nga fusha e zhvillimit territorial;
- Anëtarin e Këshillit Kombëtar të Shoqërisë Civile, përfaqësuesin e shoqërisë civile nga fusha e zhvillimit mjedisor;
- Anëtarin e Këshillit Kombëtar të Shoqërisë Civile, përfaqësuesin e shoqërisë civile nga fusha e mirëqenies, shërbimeve sociale, mbrojtjes së shëndetit dhe përmirësimit të cilësisë së jetës.

4. Komiteti Shumëpalësh mund të zhvillojë mbledhje të hapura me të ftuar të tjerë. Në mbledhjet e hapura të Komitetit ftohen të marrin pjesë, sipas rastit, si më poshtë vijon:

- Përfaqësues diplomatik nga Ambasada Amerikane, i ftuar i përhershëm;
- Përfaqësues nga USAID (dhe/ose USATA), në përputhje me tematikat e takimeve;
- Përfaqësues nga Delegacioni i Bashkimit Evropian, i ftuar i përhershëm;
- Përfaqësues nga komuniteti i partneritetit për zhvillim dhe integrim (DIP), në përputhje me tematikat e takimeve;
- Bashkëkryetari (përfaqësues i njëjësive të vetëqeverisjes vendore) i Këshillit Konsultativ mes Qeverisjes Qendrore dhe Vetëqeverisjes Vendore;
- Përfaqësues nga biznesi në Këshillin Ekonomik Kombëtar;
- Kryetari i Konferencës së Rektorëve, në përputhje me tematikat e takimeve;
- Kryetari i Akademisë së Shkencave, në përputhje me tematikat e takimeve;
- Drejtori i Përgjithshëm i INSTAT-it;
- Përfaqësues nga institucionet e pavarura, në përputhje me tematikat e takimeve.

5. Komiteti Shumëpalësh ka këto detyra dhe përgjegjësi:

- a) Të shqyrtojë dhe të nxisë vënien në zbatim të Planit Kombëtar për Qeverisje të Hapur, si dhe të sigurojë orientimin për zbatimin dhe raportimin e institucioneve për ecurinë e tij;
 - b) Të nxisë bashkërendimin në nivel të lartë të institucioneve, me qëllim orientimin dhe udhëheqjen e punës për zbatimin e politikave dhe masave për arritjen e angazhimeve për qeverisje të hapur;
 - c) Të nxisë dialogun në kuadrin e politikave dhe ndërveprimit të tyre, në zbatim të qeverisjes së hapur;
 - ç) Të shqyrtojë raportet e vetëvlerësimit të përmbushjes së masave për vendin, të përgatitura nga sekretariati, si dhe të japë rekomandime për përmirësim;
 - d) Të shqyrtojë raportet e vlerësimit nga mekanizmi i pavarur i qeverisjes së hapur për vendin;
 - dh) Të rekomandojë masat e nevojshme ligjore, si dhe të orientojë punën organizative për nisma ligjore për arritjen e angazhimeve;
 - e) Të nxisë planifikimin për financimin e masave përmes programimit buxhetor afatmesëm, bashkëpunimit me partnerët e zhvillimit, përmes sistemit të planifikimit të integruar (SPI);
 - ë) Të nxisë dialogun mes Këshillit të Ministrave dhe institucioneve të pavarura, organeve të vetëqeverisjes vendore, partnerëve për zhvillim, shoqërisë civile, për zbatimin e masave, si dhe të promovojë nismat e veprimeve të bashkërenduara në këtë kuadër.
6. Komiteti Shumëpalësh mblidhet, si rregull, të paktën tri herë në vit.
7. Komiteti kryen diskutime tematike për nxitjen dhe bashkërendimin e nismave konkrete në mbështetje të parimeve të hapjes, transparencës, gjithëpërfshirjes dhe promovimin e vlerave të qeverisjes.
8. Rregulla më të detajuara për organizimin dhe funksionimin e Komitetit Shumëpalësh përcaktohen në rregulloren e brendshme, që miratohet në mbledhjen e parë të punës së Komitetit Shumëpalësh.
9. Sekretariati i Komitetit Shumëpalësh mbi Partneritetin për Qeverisje të Hapur është struktura në nivel teknik, në Kryeministri, përgjegjëse për mirëqeverisjen dhe koordinimin ndërinstitutional të punës për Iniciativën OGP.
- Sekretariati i Komitetit, me mbështetjen teknike të partnerëve për zhvillim, kryen detyrat e mëposhtme:
- a) Siguron mbështetje teknike për veprimtarinë e Komitetit Shumëpalësh mbi Partneritetin për Qeverisje të Hapur në përgjithësi, si dhe në veçanti për procesin e ‘bashkëbërjes’, në linjë me standardet për pjesëmarrje në Iniciativën OGP-së;

- b) Siguron organizimin e mbledhjeve dhe tematikën e çështjes për diskutim, të përgatitura në bashkëpunim me ministritë dhe aktorë të tjerë, pranë Komitetit;
 - c) Koordinon procesin teknik dhe orientimin metodologjik të institucioneve në nivel teknik për përgatitjen e Planit Kombëtar për Qeverisje të Hapur;
 - ç) Koordinon procesin teknik me institucionet e ngarkuara për ndjekjen e zbatimit dhe përgatitjen e raporteve të vetëvlerësimit mbi ecurinë e zbatimit të masave të Planit Kombëtar për Qeverisje të Hapur nga institucionet e ngarkuara me to;
 - d) Siguron koordinimin e punës me institucionet për hartimin dhe shqyrtimin teknik të raporteve të vlerësimit nga mekanizmi i pavarur i qeverisjes së hapur për vendin, si edhe i paraqet Komitetit informacionet përkatëse me rekomandime;
 - dh) Koordinon punën për përgatitjen e nismave të nevojshme ligjore, si edhe masave në lidhje me planifikimin për financimin në programin buxhetor afatmesëm;
 - e) Koordinon punën ndërmjet Komitetit, institucioneve publike dhe partnerëve për zhvillim, si dhe partnerëve socialë e aktorëve të tjerë të interesuar;
 - ë) Siguron drejtimin metodologjik dhe teknik të punës, për përgatitjen e instrumenteve të efektshme teknike për arritjen e angazhimeve në Planin Kombëtar;
 - f) Kryen çdo detyrë tjetër që i ngarkohet nga Komiteti, në përmbushje të përgjegjësive të veta.
10. Ngarkohet Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile të dërgojë brenda 7 (shtatë) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij urdhri, pranë kabinetit të Zëvendëskryeministrit emrat e përfaqësuesve të shoqërisë civile, anëtarë të Komitetit, sipas pikës 3.
11. Ngarkohet Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit për publikimin e informacionit mbi veprimtarinë e Komiteti Shumëpalësh, të cilat vihen në dispozicion nga sekretariati, në portalin e qeverisjes së hapur.
12. Ngarkohen anëtarët e Komitetit Shumëpalësh dhe sekretariati për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E M I N I S T R I

EDI RAMA

NR.PROT. 6407/1
DATË 21. 12. 2021

ZËVENDËSKRYEMINISTRIT
MINISTRISË PËR EVROPËN DHE PUNËT E
JASHTME
MINISTRISË SË BRENDSHME
MINISTRISË SË FINANCAVE DHE EKONOMISË
MINISTRISË SË DREJTËSISË
MINISTRIT TË SHTETIT PËR STANDARDET DHE
SHËRBIMET
MINISTRIT TË SHTETIT PËR MBROJTJEN E
SIPËRMARRJES
AGJENCISË KOMBËTARE TË SHOQËRISË SË
INFORMACIONIT
AGJENCISË PËR MBËSHTETJEN E SHOQËRISË
CIVILE
KËSHILLIT KOMBËTAR PËR SHOQËRISË CIVILE
AGJENCISË PËR DIALOG DHE
BASHKËQEVERISJE
SHOQATËS PËR AUTONOMINË VENDORE

Sekretari i Përgjithshëm

Engjëll AGAÇI

